

Nikos Kazantzakis

2
LETÉRSI

ZOЯBA



roman



NIKOS KAZANTZAKIS

ZORBA

Nikos Kazantzakis

Zorba

roman

Botimi i 1-rë, tetor 2016
Shqipërues: Stavri J. DAJO
Redaktore: Eljona ZANA
Faqosje: Markel DAJO
Kopertina: Romina BALLAMAÇI

Titulli i origjinalit: Vios kai politeia tou Alexi Zorba

ISBN: 978-618-82114-2-1
© për gjuhën greke: Niki Stavrou
© për gjuhën shqipe: Literatus

Botime Literatus
Odysseos 6, 54627 Selanik
T. +30 2310516251 • F. +30 2310533900
www.literatus.gr • info@literatus.gr

Askush, subjekt privat apo shtetëror, nuk ka të drejtë të riprodhojë, përdorë dhe të botojë, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, tekstet e këtij botimi, pa miratimin paraprak të botuesit përveç rasteve kur tekstet shërbejnë për citim.

NIKOS KAZANTZAKIS

ZORBA

roman

Shqipërim i ripunuar: Stavri J. DAJO

LITERATUS

Selanik 2016

NË KËRKIM TË JETËS

Parathënie

Romani i Nikos Kazanxaqis (Nikos Kazantzakis) *Zorba*¹, përbën një nga veprat më të njohura të shkrimtarit dhe kualifikohet ndër 100 librat më të mirë të të gjitha kohërave të letërsisë botërore, sipas Qendrës Norvegjeze të Librit (2002). Romani u botua fill pas luftës (1946, ribotuar në vitet 1954, 1955, 1957, 1959 dhe, në vijim, shumë herë nga ente të ndryshëm botues), por u shkrua pjesërisht në kohën e pushtimit (1941-1943). Ky roman, i pari shkruar në greqisht nga autori, gjendet në mes të kolanës së romaneve të tij, midis veprave paraprijëse -jo dhe aq të arrira- dhe veprave pasardhëse -plotësisht të suksesshme. Pas krijimit të figurës së Odiseut, udhëtimeve pa fund dhe lektisjeve të tij, në veprën lapidare poetike homonime *Odiseu* (33.333 vargje), *Zorba* është, në një farë kuptimi, tërësimi i figurës së grekut tipik bashkëkohor, real, jetësor, simbol i njeriut të vetvetishëm që kërkon të jetojë çdo moment të jetës, duke arritur, kështu, amshimin pas vdekjes, mishëron mendësinë popullore greke. Gërshetuar me heroin kinematografik *Zorba* [interpretuar mjeshhtërisht nga Antoni Kuin (Anthony Quinn) tek filmi i famshëm i Hollivudit, *Zorba the Greek*, 1964] figura romaneske e Kazantzakis është njësuar me grekun e kohërave moderne në kundërvënie me mendësinë dhe qytetërimin antik². Me romanin *Zorba*, pra, zë fill karriera e mirëfilltë e

¹ Titulli i originalit: *Vios kai Politeia tou Alexi Zorba* (Jeta dhe kultura e Aleks Zorbës).

² *Zorba* ka ekzistuar dhe si figurë reale (Georgios Zorbas), të cilin autori e ka njohur në minierat e linjtit në zonën e Manit të Greqisë dhe është ndikuar shumë nga ai. Pra, *Zorba* ekziston në tre përmasa: si figurë jetësore (janë ruajtur qindra letra të shkëmbyera mes autorit të

Kazantzakis si shkrimtar prozator; deri atëherë ai nuk shprehte mëtime në zhanrin e prozës, por ëndërronte të afirmohej si një poet i madh i të gjithë kohërave, si Homeri apo Dante Alighieri. Madje, të parin e kishte sjellë në greqishten e re (bashkë me folkloristin Kakridis), ndërsa *Komedinë Hyjnore* e kishte përkthyer greqisht. Me romanin *Zorba*, Nikos Kazantzakis arriti të përjetësonte personalitetin e tij letrar i cili mbetet po kaq i spikatur dhe i paprekshëm edhe sot e gjithë ditën, pas shumë e shumë dekadash.

Jeta dhe vepra e Nikos Kazantzakis

Nikos Kazantzakis është një personalitet poliedrik: poet, shkrimtar prozator, eseist, kritik letrar, publicist, përkthyes i letërsisë, dramaturg, politikan etj. U lind në Iraklio (Irakleio) të Kretës më 18 shkurt 1883, në kohën kur ishulli i Kretës vijonte të ishte pjesë e Perandorisë Osmane dhe vdiq më 26 tetor 1957 në Frajburg (Freiburg) të Gjermanisë. Vinte nga familje atdhetarësh dhe tregtarësh; i ati ishte figura legjendare e Kapedan Mihalit, të cilin e përshkruan në veprën e tij *Ja vdekje ja liri*³. Në vendlindje u shkollua minimalisht ndërsa në vijim në ishullin Naksos (Naxos) ndoqi një gjimnaz francez ku erdhi në kontakt me kulturën dhe gjuhën franceze dhe italiane.

Më vonë, në Athinë ndoqi studimet për drejtësi dhe fitoi titujt akademikë me rezultate të shkëlqyera. Diplomën e tij universitare e firmosi një tjetër kolos i letrave greke, Kostis Palamas, i cili atëherë mbante vendin e sekretarit të Universitetit, por lidhja e dy personaliteteve të letërsisë greke nuk evidentohet më gjatë, siç ndodhi me miqësinë e tij shumëvjeçare me Angjelos Sigelianos (Angelos Sikelianos), një poet i mirënjohur bashkëkohor me të.

Botimi i tij nistor regjistrohet në vitin 1906, kur autori

romanit dhe heroit të tij), *Zorba* si figurë letrare dhe *Zorba* si figurë kinematografike.

³ Romani u botua në shqip në vitin 1973, shqipëruar nga frëngjishtja nga Enver Fico.

ishte ende në moshë relativisht të re. Në vitin 1919 Eleftherios Venizelos e emëron Drejtor të Përgjithshëm të Ministrisë së Asistencës Sociale me mision të posaçëm riatdhesimin e grekëve nga Kaukazi pas ndjekjeve dhe spastrimeve etnike. Ishte një përvojë e hidhur të cilën më vonë Kazantzakis do ta përdorë si lëndë të parë për romanin *Krishti rikryqëzohet* (1954).

Kazantzakis udhëtoi shumë dhe produkt i udhëtimit të tij janë shënimet e udhëtimit, një formë letrare *sui generis*, ndoshta nga prodhimi i tij më cilësor estetik, edhe pse, në krye, u përdorën si shkrime dhe korrespondenca publicistike për nevoja të shtypit politik të kohës⁴.

Nikos Kazantzakis u emërua dhe ministër pa portofol për një kohë të shkurtër (1945-1946) por edhe si punonjës i UNESCO-s (1947-1948) për promovimin e letërsisë klasike.

Kazantzakis ishte dy herë kandidat për të fituar çmimin Nobel (1947, 1950) por përfundimisht nuk e fitoi atë.

Në mënyrë absurde, Kazantzakis u akuzua nga të dy ekstremet, e majta dhe e djathta, si komunist dhe, për sakrilegj, dhe nga kisha ortodokse e cila në vitin 1954 kërkoi ndalimin e veprës së tij letrare. Konflikti i tij me kishën ortodokse arriti kulmin kur ajo guxoi shkishërimin e tij, por pa arritur ta realizonte atë. Konflikti kishë - shkrimtar nuk rreshti deri me vdekjen e shkrimtarit me pasojë Kazantzakis të mos varroset në varrezat publike si i krishterë ortodoks, por në muret e kështjellës mesjetare në Irakleio, në varin e të cilit është vendosur mbishkrimi epitaf, marrë nga libri i tij *Asketika* (1927):

Nuk shpresoj asgjë, nuk i frikësohem kujt, jam i lirë!

Çështja e veprës

Në roman përshkruhet njohja dhe kronika e miqësisë së

⁴ Shkrimet dhe librat e udhëtimit të Nikos Kazantzakis mund të krahasohen me ato të Ernest Heminguej (Ernest Hemingway, 1899-1961) të së njëjtës periudhë.

autorit të romanit, Nikos Kazantzakis me heroin e tij Georgios Zorbas, në minierat e linjtit në zonën e Manit. Ngjarjet e romanit zhvillohen në ishullin e Kretës ku heroi real shndërrohet në personazh artistik, Aleks Zorba. Takimi i parë i heronjve të veprës (autorit dhe personazhit kryesor të tij) në Pire, i lë përshtypje të madhe Kazantzakis, për shkak të karakterit antikonzvencional të Zorbës si dhe pasionit të tij për të filozofuar për jetën: Ky patos e bën atë që ta punësojë në biznesin e tij si përgjegjës kantieri. Në vijim, të dy vendosen në Kretë, në hotelin e madam Ortansës, një grua e rrënuar moshe, por që nuk vonon të bëhet dashnorja e Zorbës, një nga gratë e shumta që kanë kaluar në jetën e tij të shumëtrazuar. Shumica e bisedave me karakter thellësisht filozofik dhe meditativ, për elementët kryesorë të jetës, vdekjen, dashurinë, përkushtimin, pabesinë, të vërtetën dhe gënjeshtrën, stoicizmin si dhe për shumë vlera të tjera gjithëkohore zhvillohen në kantieret e linjtit, por, në fakt, shkrimtari nuk interesohet shumë për mbarëvajtjen e punës se sa për të rrëmuar në shpirtin e heroit të tij dhe për të mësuar të vërtetat e jetës dhe për të marrë përgjigje për pyetjet e përjetshme që mendojnë njeriun: nga vjen dhe ku shkon, ç'raport kemi ne me botën, me komplekset, lirinë, dhunën, frikën, humanizmin, atdheun, racën, jetën, trashëgimitë, besëtytnitë, bindjet fetare, morale e politike? A duhet të kemi frikë nga vetvetja, po nga bashkënjëriu ynë? Simboli i Zorbës pozicionohet kundër vanitetit të nacionalizmit dhe luftërave vrastare. Zorba, si njeri praktik, i pandikuar nga librat, leximet dhe skemat filozofike, përpiket që t'i dëshmojë shkrimtarit se përgjigjet që e mendojnë një jetë të tërë atë dhe, në përgjithësi, çdo intelektual, nuk gjenden tek ndërlikimet logjike dhe deduksionet e pashpjegueshme, as tek librat, por në praktikën e përditshme të jetës; për ato njeriu merr përgjigje natyrshëm, mjafton që të jetojë çdo çast me pasion si të jetë dita e fundit e jetës së tij dhe të punojë po me pasion, sikur nuk do të vdesë kurrë, i privuar nga çdo shpresë, çdo botëkuptim dhe çdo kompleks. Edhe pse i panxënë, Zorba ka dije të shumta e të thella, shpesh shpreh të

vërteta të padyshimta me vlerë të konfirmuar praktike dhe mbarëkohore, ka nuhatjen e pagabuar të një njeriu që e ka rrahur jeta “me vaj e me uthull”.

Heronjtë

Protagonistë të veprës janë vet shkrimtari Nikos Kazantzakis dhe Zorba. Të dy këta funksionojnë si alter ego në veprë. Esenca estetike dhe ideologjike e veprës gjendet pikërisht në deduksionin e pafund filozofik të Zorbës dhe në përshkrimin me lavde dhe adhurim nga shkrimtari, por shpesh dhe me frikë, skepticizëm dhe prapakttime nga ana e këtij të fundit.

Figurë tjetër është madam Ortansa dhe Vejusha, me një implikim anësor, vetëm për të nxjerrë në pah anë të karakterit pasionant dhe aktiv të Zorbës dhe pasiv të shkrimtarit, humbur në meditime pafund dhe mëdyshje delirante. Zorba dëshiron ta jetojë jetën, shkrimtari ta shpjegojë atë. Kjo është diferenca e tyre themelore.

Figura të tjera dytësore janë: Mimithoja, xha Anagnosti, kapedan Mavrandoni, kryeplaku, Manolaka, Kontomanoliosi etj. të cilët në intrigën e veprës shpalosin anë të ndryshme të dy heronjve kryesorë.

Përmbajtja ideologjike dhe estetike e veprës

Zorba duhet konsideruar si një vepër shumë e guximshme për kohën kur u botua.

Baza ideologjike dhe estetike e veprës është polarizimi i dy figurave qendrore: Zorbës dhe shkrimtarit. Në ndërmjet, gëlojnë figura dhe ide të ndryshme, që janë periferike dhe nuk paraqesin interes të veçantë ideologjik, por jo dhe estetik. Është për të theksuar se autori huazon titullin e veprës së tij nga librat kishtarë për të shenjtëruar ndoshta kryeheroin e tij, si një shenjtor real dhe bashkëkohor, për ta mbështjellë dhe njëkohësisht çmbështjellë atë me një petk mistik.

Në qoftë se do të skematizonim elementët kryesorë moralë të këtyre dy figurave do të kishim:

Shkrimtari	Zorba
Spektator i jetës	Protagonist i jetës
Teori	Praktikë
Dije	Përvojë
Shpirt	Trup
Inteligjencë	Materie
I përmbajtur asketik	Kënaqësi mishtore
Kinse serioz	I vetvetishëm
Dijetar	Popullor
Stimë e lartë	Stimë e zakonshme ⁵

Në këtë polarizim shkrimtari shpreh simbolin e ekzistencës shpirtërore dhe Zorba atë të jetës reale; jeta është si një lumë i papërmbajtur dhe i papenguar, nuk izolohet, nuk mënjanohet dhe, aq më shumë, nuk eksperimentohet në laboratorin filozofik të dijës, veçse jetohej dhe jetohej vetëm njëherë.

Vlerat artistike të veprës

Romani spikat së pari për figurat reale dhe të besueshme të protagonistëve, për situata dramatike dhe komike të përshkruara me mjeshtri të lartë artistike por, më së pari, për gjuhën e punuar, të pasur me shprehje dhe togefjalësha të ngulitur (çka e bëjnë shumë të vështirë teknikën e shqipërimit), me mjete shprehëse befasuese me një gërshetim mjeshhtëror të stileve të ndryshëm (Zorba popullor - shkrimtari intelektual) si dhe për meditimet e thella filozofike, por që nuk të lodhin pasi shpalosen përmes së folmes së thjeshtë dhe popullore të Zorbës. Autori i kushton më shumë rëndësi skalitjes së karaktereve dhe jo ngjarjeve dhe intrigës artistike. Në një kuptim tjetër, vepra mund të konsiderohet edhe një formë autobiografie letrare, siç është në të vërtetë (Shkrimtari) në kundërvënien me tipin tjetër jetësor (Zorba) të cilin dhe e admiron (sepse e shpreh së brendshmi, si dëshirë) por,

⁵ Nikos Kazantzakis, *Vios kai politeia tou Alexi Zorba*, (Parathënia e Nikos Mathioudakis), Athinë 2013, fq. 8.

njëherësh, mban distancë prej tij, sepse nuk mundet dhe nuk do të jetojë si ai. Vet Kazantzakis e cilëson veprën e tij si një dialog mes një kalemxhiu dhe një njeriu të madh të popullit, dialog mes avokatit Mendje dhe Shpirtit të madh të popullit⁶. Por, në një pikëpamje tjetër, vepra është dhe një dyzim i vet shkrimtarit ose, thënë ndryshe, një mëdyshje e brendshme e Egos ekzistente të një Shkrimtari dhe një Egoje tjetër të dëshiruar prej tij, por inekzistente.

Romani ka një gjallëri admiruese, mprehtësi në mendim, vrojtueshmëri, por edhe një pesimizëm të çiltër dhe gati-gati fëmijëror e keqardhës, ndjenjë, humor burimor dhe të shëndoshë, por aspak denigrues ndaj diversitetit të tjetrit, mençuri dhe stil të besueshëm, pa asnjë artific.

Vlerësimi kritik i veprës dhe përkthimi në gjuhë të huaja

Zorba është nga librat e paktë letrarë në historinë e letërsisë botërore që janë vlerësuar vetëm me kritika pozitive, me ndonjë përjashtim të papërfillshëm, siç është kritika e majtë e cila mëtonte nga shkrimtari që të përshkruante gjendjen e mjerë të popullit në pushtimin gjerman (sic!). Sipas studuesve të Kazantzakis, vepra ka ushtruar një ndikim të madh në brezat e mëvonshëm letrarë, si vet figura letrare e Zorbës ashtu dhe stili original romanesk.

Nikos Kazantzakis drejtësisht evidentohet si shkrimtari bashkëkohor grek më me shumë përkthime në botë, madje bashkë me Orhan Pamukun (çmimi Nobel, 2006) dhe Ismail Kadarenë janë tre shkrimtarët më të përthyer të Ballkanit. Vepra e tij përfaqësuese mbetet, padyshim, *Zorba*. Sipas regjistrimeve të Qendrës Kombëtare të Librit në Athinë, evidentohen më shumë se 580 botime të librit në botë, përkthyer në mbi 40 gjuhë të ndryshme, duke u klasifikuar në vendin e parë të librave të letërsisë greke, përkthyer në botë. Ky numër shtohet vazhdimisht duke e shndërruar librin në një

⁶ Eleni Kazantzaki, *Nikos Kazantzakis pa kompromis*, Biografi, Athinë 1983, fq. 567.

libër klasik aktiv. Në vitin 1954 *Zorba* u shpall romani më i mirë i huaj i botuar në Francë. Romani u vlerësua lart dhe nga shkrimtarë të mirënjohur botërorë, si Albert Schweitzer (Shvajcer) (1875-1965), Tomas Mann (1875-1955), Albert Cammy (1913-1960), të cilët e vlerësojnë si një nga shkrimtarët më të mëdhenj evropianë.

Nikos Kazantzakis dhe sidomos libri i tij i pranishëm ka ushtruar një ndikim diakronik tek lexuesi grek dhe i huaj. Pas një apoteoze të ndjeshme në vitet 1960-1970 dhe uljes së interesit leximor për të (edhe për shkak të keqkuptimeve lidhur me vlerësimin e tij nga kritika e institucionalizuar e cila e paragjykonte si komunist dhe kritika teologjike që e kishte denigruar) interesi për Nikos Kazantzakis u rrit në fillimet e shekullit të 21-të, i cilësuar si shkrimtar i thellë meditativ me një nënshtresë të qëndrueshme teologjike, por deri diku dhe ekzistencialiste. Përmbajtja ideologjike dhe estetike e veprës së tij i ka rezistuar dhe do t'i rezistojë kohës në sajë të vlerave universale të mesazheve që përcjell. E tërë vepra e tij letrare, por në mënyrë të veçantë *Zorba*, është një himn për jetën dhe një fshikullim kundër pesimizmit, dilemave dhe kundërvënieve introversive absurde si dhe paranojave pa kuptim të binomit *jetë-mosjetë* si dhe ndaj zhgënjimeve. Vepra pati dhe një ndikim të jashtëzakonshëm dhe në lloje dhe zhanre të tjera të artit dhe të kulturës, si në muzikë, pikaturë, balet, kinematografi.

Nuk është rastësi fakti që Nikos Kazantzakis klasifikohet në vendin e parë të shkrimtarëve grekë me ndikimin më të madh tek lexuesi, sipas sondazheve të fondacioneve të ndryshme, por edhe sipas studiuesve të huaj të cilët mendojnë se Nikos Kazantzakis do të vijojë të mbetet shkrimtari më i lexuar për dy shekujt e ardhshëm, në sajë të universalitetit të veprës së tij, por dhe si shkrimtar që kultivoi pothuajse të gjitha llojet e letërsisë, një vepër vërtet voluminoze por edhe të suksesshme.

Dr. Stavri J. DAJO

SHËNIM I BOTUESIT

Në gjuhën shqipe janë dhënë 14 vepra letrare të Nikos Kazantzakis, duke u zgjedhur kështu në vendin e parë të shkrimtarëve grekë të shqipëruar.

Një bibliografi e rastit e botimeve në shqip të autorit do të ishte⁷:

Ja vdekje ja liri, Καπετάν Μιχάλης, Λευτεριά ή Θάνατος, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Fico, Enver, Tiranë, Naim Frashëri 1973, 1992.

Vëllavrasësit, Οι αδερφοφάδες, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Varfi, Nonda, Tiranë, Albin 1997.

Krishti kryqëzohet përsëri, Ο Χριστός ξανασταυρώνεται, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Qesko, Harrallamb, Tiranë, Albin 1998, Toena 2010.

Komedi, Teatër, Κωμωδία, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Hoxha, Teuta, Tiranë, Neraida 2000.

Zambaku dhe gjarpri, Όφις και κρίνο, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Mero, Leonard, Tiranë, Onufri 2000.

Heronjtë e mi - Biseda, Οι ήρωες μου, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Mero, Leonard, Tiranë, Onufri 2000.

Letër El Grekos, Αναφορά στο Γκρέκο, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Gubera Miço, Tiranë Uegen 2001.

Zorba, Βίος και πολιτεία του Αλέξη Ζορμπά, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Rrahmani Nazmi, Prishtinë, Rilindja 1978.

Zorba, Βίος και πολιτεία του Αλέξη Ζορμπά, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Dajo, Stavri, Tiranë, Albin 1996, 2001.

Asketika, Η Ασκητική, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Dibra, Klodeta, Tiranë, Albin 2002.

⁷ Sipas studiueses dhe përkthyeses Maklena Nika.

- Kazanxaqis dhe Zorba - miniantologji*, O Καζαντζάκης και ο Ζορμπάς - Μινιαντολογία, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Hoxha, Teuta, Tiranë, Neraida 2002.
- Udhëtojt nëpër Japoni dhe Kinë*, Ταξιδεύοντας Ιαπωνία-Κίνα, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Dino, Mimoza, Tiranë, Dudaj 2003.
- Udhëtim në Malin e Shenjtë*, Ο φίλος μου, ο ποιητής, Καζαντζάκης Νίκος, shqipëruar nga Çollaku, Romeo, Tiranë, Zenit 2013.
- Udhëtim nëpër Itali, Egjipt, Sinai, Jerusalem, Qipro, More*, Ταξιδεύοντας Ιταλία, Αίγυπτος, Σινά, Ιερουσαλήμ, Κύπρος - Μοριάς, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Maklena Nika, Tiranë, Toena 2014.
- Tundimi i fundit*, Ο τελευταίος πειρασμός, Καζαντζάκης, Νίκος, shqipëruar nga Çollaku, Romeo, Tiranë, Pegi, 2015.

Romani *Zorba* u shqipërua për herë të parë nga serbokroatishtja në vitin 1978 nga Nazmi Rrahmani dhe u botua nga Rilindja në Kosovë, por botimi nuk pati jehonë në Shqipëri, ngase u mbajt i rezervuar nga institucionet ideologjike të kohës, por dhe ngaqë shqipërimi i romanit u bë nga një gjuhë e dytë, ndofta dhe e tretë.

Shqipërimi i pranishëm u realizua gjatë viteve 1987-1988, por u botua për herë të parë shtatë vjet më vonë (1994, ribotuar 2001) për shkak të kufizimeve të njohura ideologjike të kohës. Libri u prit me entuziazëm nga lexuesi i gjerë dhe me lavde nga kritika letrare e kohës si për vlerat e tij estetike, ashtu dhe për nivelin e lartë të shqipërimit⁸.

Me kalimin e viteve dhe pas dinamikës së zhvillimit të standardit shqip, u pa e udhës që vepra t'i nënshtrohej një

⁸ Shih në mënyrë indikative: Nasho Jorgaqi, N. Kazanxaqisi dhe 'Jeta e Aleksis Zorbas' parathënie, *Jeta e Aleksis Zorbas*, Albin 1996, fq. 12. *Gazeta Shqiptare*, 15.06.1996. *Zëri i Popullit*, 18.07.1996. *Koha jonë*, 12.09.1996. *Demokracia*, 15.09.1996. *Rilindja Demokratike*, 16.09.1996. *Dita Informacion*, 26.09.1996. *Demokracia*, 06.10.1996.

përpunimi të thellë; versioni i pranishëm përbën një ripunim tërësor dhe të pasuruar të variantit nistor.

Shtator 2016

HYRJE

Shumë herë jam vënë të shkruaj jetën dhe botëkuptimin e Aleks Zorbës, një punëtor plak që e kam dashur me shpirt.

Mirëbërësit më të mëdhenj të jetës sime qenë udhëtimet e largëta dhe ëndrrat; ndër njerëzit, të gjallë e të vdekur, shumë pak qenë ata që më ndihmuan në luftë e në përpjekjet e mia. Porse, nëse do të veçoja se kush prej tyre la gjurmë më të thella në shpirtin tim, do të përmendja, ndoshta, trekatër: Homerin, Bergsonin, Niçen dhe Zorbën.

I pari ishte për mua një sy i madh me dritë shkëlqimtare, si disku i diellit që ndriçon gjithçka me vezullimin e vet të praruar. Bergsoni më lehtësoi nga ankthet e ngatërruara filozofike që më mundonin në djalërinë time të parë. Niçja më begatoi me ankthe të reja dhe më mësoi si të shndërroj fatkeqësinë, trishtimin dhe pasigurinë në krenari, ndërsa Zorba më mësoi të dua jetën dhe të mos i trembem vdekjes.

Po të më këërkohej sot të zgjidhja një prijës shpirtëror nga e gjithë bota, një “gurú” sipas gjuhës së indasve a një “plak” sipas murgjve të Malit të Shenjtë⁹, do të kisha zgjedhur pa mëdyshje Zorbën.

Ai i kishte të gjitha cilësitë e një kalemxhiu për të shpëtuar: vështrimin e moçëm të shqiponjës që shquan së larti prenë e saj, naivitetin krijues e të përtërirë rishtas e rishtas çdo mëngjes, që gjithçka e shikon si për herë të parë, vazhdimisht, pavarësisht se e ka parë mijëra e mijëra herë, duke u dhënë virgjërinë elementëve të përjetshëm e të rëndomtë, ajrit, detit, zjarrit, gruas, bukës. Ai kishte sigurinë e dorës, freskinë e zemrës, guximin për të përqeshur dhe vetë shpirtin e tij a thua se përbrenda i buronte një forcë su-

⁹ Agio Oros, zonë e vetadministruar e shtetit grek në Gadishullin e Athos, në Halkidiki e cila popullohet nga murgj dhe monastire (shënimet janë të shqipëruarit).

preme, më e madhe se shpirti dhe, në fund, kishte dhe një cilësi tjetër, të qeshurën e vrazhdë e të cemtë që gurgullonte krojeve të thella, më të thella se vetë shpirti njerëzor e që dilte me gulfe e suvala nga gjoksi i venitur e i plakur i tij, një e qeshur jetëdhënëse e shpëtimtare në çastet kritike të jetës. Shpërthente dhe mund të rrëzonte -madje i rrëzonte- të gjitha gardhet: moralin, fenë, atdheun që kishte ngritur përreth njerëzia, frikacaku që ta kalonte jetën pa telashe e kokëçarje.

Kur mendoj se ç'ushqim më kanë dhënë vite e vite librat dhe mësuesit e mi, për të ngopur një shpirt të babëzitur dhe me çfarë tru luanësh më ushquu Zorba vetëm në pak muaj, zor se mund të përmbaj mllefën dhe pikëllimin. Nga një rastësi e thjeshtë, jeta ime mori kot. Ishte shumë vonë kur e hasa rrugës së jetës këtë "Plak" dhe ajo çka mund të shpëtonte tashmë nga shpirti im ishte pa vlerë. Kthesa e madhe, ndërrimi tërësor i frontit, "shpërthimi" dhe "përtëritja" nuk ndodhin më. Ishte pra, vonë. Kësisoj, në vend që të shndërrohej në një model të përsosur jete, Zorba degradoi në një objekt filologjik (ah, medet!) vetëm e vetëm për të shkarravitur ca fije letre!

Kjo prijje e trishtueshme për ta shndërruar jetën në art, shpeshherë kthehet në një rrënim të përgjithshëm shpirtëror, sepse, në këtë mënyrë, duke parë si rrugëzgjidhje të vetme ndjenjën e fuqishme, ajo arratiset nga kraharori dhe lehtëson shpirtin, i cili shpëton pa plasur e nuk ndjen më atë nevojë gërryese për t'u përleshur trup me trup duke ndërhyrë tërthorazi në jetën e përditshme - po gëzohet duke përjetuar këtë ndjenjë mitare e cila kapërthehet e shuhet sakaq.

Dhe jo vetëm gëzon, por është dhe krenar. Kujton se ka kryer një akt sublim: çastin kalimtar të patjetërsueshëm; të vetmin në fushëtirën e pafund të kohës që ka mish dhe gjak e shndërruaka, gjoja, në amshim. Kështu Zorba, gjithë mish e eshtra, mbeti në duart e mia bojë dhe letër. Pa dashur, madje duke dashur të kundërtën, nisi që herët të ravijëzohej tek unë miti i Zorbës. Nisi përpunimi i brendshëm mistik: në fillim një muzikë rebeluese, një epsh i zjarrtë e një padurim mundues a thua se kishte depërtuar në gjakun tim një trup i huaj

dhe organizmi im bënte çmos për t'i vënë fre, për ta zhdukur duke e asimiluar. Kështu, rreth kësaj bërthame, nisën të shtilleshin fjalët që e ushqenin mitin si embrion. Kthjelloheshin kujtimet e vagëlluara, brofnin përpara gëzimet e trishtimet e mbytura, jeta mbartej në një mjedis të ajërt më të lehtë dhe Zorba shndërrohej në legjendë.

Ende s'e kisha të qartë se ç'formë duhet t'i jepja kësaj përralle të Zorbës: romancë, këngë, tregim fantastik i ngatërruar i tipit të "Një mijë e një netëve" apo të regjistroja thatë e besnikërisht bisedat që patëm bërë në një bregdet të Kretës, në kohën që kërkonim gjoja linjit. E dinim mirë se ky qëllim dobiprurës na shërbente veç për t'u hedhur hi syve njerëzve. E linim punën ngutas, duke pritur sa të perëndonte dielli, të mbaronin punëtorët punën, të shtroheshim tok në ranishtë, të hanim hajen avulloste e me shije të fshatit, të rrokullisnim dhe ndoca gota verë të vjetër kretase dhe t'ia krisnim muhabetit.

Unë, në më të shumtën e herëve, heshtja. E ç'mund t'i thoshte "një intelektual" këtij dragoi? Rrija dhe dëgjoja gjithë sy e veshë, kur më tregonte për fshatin e tij atje tej, rrëzë Olimp, për dëborën, për ujqërit, komitet, Shën Sofinë, qymyrgurin, gurin e bardhë, gratë, Zotin, atdheun dhe vdekjen dhe, befas, tek s'e përmbante më veten e s'i mjaftonin fjalët, brofte përpjetë e ia niste valles në ranishtën me zall të trashë.

I shkuar moshe, shtatngjeshur, eshtak, me kokën anuar paksa prapa, me një palë sy të vegjël e të rrumbullakët si të zogut, kërcente duke klithur e vikatur, rrihte putrat e trasha të këmbëve në zall dhe më stërpikte fytyrën me spërka të kripura deti.

Po t'i kisha shkuar pas zërit -jo zërit, sokëllimës- jeta ime do të kishte marrë vlerë. Do t'i kisha jetuar vetë, me mish e gjak ato përfytyrime delirante që mundohem t'i përshkruaj tani në letër.

Por s'ma mbajti. Shikoja Zorbën që vallëzonte duke hingëllirë e duke më thirrur që të shkundesha dhe unë nga guaska butake e shprehive dhe e zakonit dhe të nisesha në

udhëtime të largëta me të, por unë ngurroja duke u dridhur si kulmak.

Shumë herë në jetën time më ka ardhur turp, sepse kam kapur shpirtin që më dridhej se s'ia mbante të bënte atë që më diktonte ndjenja, thelbi i jetës, po asnjëherë s'u turpërova për atë shpirt aq shumë sa atëherë para Zorbës.

Një mëngjes, në të gdhirë, u ndamë. Unë mora përsëri rrugën për në vende të largëta, për të shpëtuar nga sëmundja faustiane e të nxënit, ndërsa ai mori nga veriu dhe u shpërngul në Serbi, në afërsirat e Shkupit ku pat gjetur, siç tregoi, një damar të begatë me gur të bardhë. Futi në thes ca parallinj, bleu vegla, mobilizoi punëtorë dhe nisi përsëri të hapte galeri thellësive të dheut. Shpërtheu shkëmbinj, ndërtoi rrugë, sollti ujë, bëri shtëpi, u martua -plak kokorosh- me një vejushë qejflie, me Ljubën, dhe lindi me të dhe një djalë.

Një ditë në Berlin më erdhi një telegram: "Gjeta një gur të çmuar jeshil, nisu pa humbur kohë! Zorba".

Ishte në kohë të urisë së madhe në Gjermani. Marka kishte rënë kaq poshtë, saqë, për të bërë një pagesë të vogël, duhet të ngarkoje thasët me miliona. Kur shkoje në restorant për të ngrënë, hapje çantën e fryrë me para dhe e lëshoje të tërën mbi tavolinë për të paguar. Kishte ardhur pikërisht ajo ditë që, për të blerë një pullë poste, duheshin plot dhjetë miliardë marka!

Uri, të ftohtë, xhaketa të terura, brashnja, faqet e kuqe të gjermanëve verdhur e bërë meit. Erë vjeshtake, njerëzit binin rrugëve si fletë plepi. Foshnjave u jepnin një copë gomë për t'u mbllaçitur, për t'i gënjyer që të mos qanin. Policia ruante urat për të mos lejuar nënat të binin e të mbyteshin në lumë me gjithë fëmijë.

Dimër, binte borë. Në odën përbri, një profesor gjerman, kinezolog, për t'u ngrohur, merrte një penel të gjatë dhe me atë mënyrë sfilitesë të Lindjes së Largët mudohej të kopjon-te një këngë të moçme kineze a ndonjë maksimë të Konfucit. Maja e penelit, bërri i ngritur pezull dhe zemra e dijetarit duhet të formonin një trekëndor.

- Pas pak minutash, - më thoshte ai i ardhur në qejf - më

shkon djersa sjetullave dhe kështu ngrohem.

Pikërisht atyre ditëve mora telegramin e Zorbës. Në fillim më erdhi inat. Miliona njerëz rrëzohen e bien në gjunjë për një kothere buke dhe -urdhëro të lutem- këtë telegram: të nisesh nga anë e anës, mijëra kilometra larg për të parë një gur të çmuar! Mallkuar, ofshava, o bukuri, se qenke e pashpirt e s' do t'ia dish për dhimbjen e njeriut.

Por, befas, u tmerrova. Inati po më binte ca nga ca dhe ndieja me njëfarë tmerri se kjo sokëllimë jonjerëzore e Zorbës i përgjigjej një sokëllime tjetër jonjerëzore brenda meje. Një shpend i egër grabitqar rrahu krahët brenda meje dhe u sul të ikte.

Po unë s'u nisa. Përsëri s'ma mbajti. Nuk u futa në tren, nuk iu binda klithmës sime të brendshme qiellore e nuk e bëra as kësaj here atë akt trimëror absurd. Shkova pas zërit të matur, të ftohtë e njerëzor të logjikës. Dhe mora penën e i shkrova Zorbës. I shpjegoja...

Dhe ai m'u përgjigj.

"Zotëri, je, me nder teje, kalemxhi. Kishe rastin, o i zi, të shikoje dhe ti njëherë në jetën tënde një gur të bukur, jeshil e nuk erdhe. Për besë, rrija dikur, kur isha pa punë, dhe ia bëja me vete: Ka a s'ka Ferr, xhanëm? Po dje, sa mora letrën tënde, thashë: Duhet të ketë Ferr, patjetër, për një takëm kalemxhinjsh!"

Vërshuan kujtimet, shtynin njëri-tjetrin, nguteshin. Është koha t'u vënë rregull. Ta nisim jetën e Zorbës që në krye. Edhe detajet më të rëndomta që lidhen me të, shndërrojnë qartë në mendjen time, të shkathëta e të çmuara si peshq laranë në një det të tejdukshëm vere. Asgjë e tij s'ka vdekur tek unë, ajo që preku Zorba u bë e pavdekshme. E, megjithatë, ato ditë më mundonte një brengë e beftë: kam dy vjet pa marrë letër nga ai, do të jetë shtatëdhjetë e kusur vjet, mund të jetë dhe në rrezik. Me siguri, do të jetë në rrezik, ndryshe s'ka si shpjegohet nevoja e ngutshme që më sundoi të grumbulloj gjithçka të tij, të kujtoj çka më rrëfeu dhe bëri e t'i hedh në letër në mënyrë që të mos zhduken. Sikur kërkoj të ysht vdekjen, vdekjen e tij. Kam frikë se ky që shkruaj nuk

do të jetë libër, por Përshpirtje.

Me sa shoh, i ka të gjitha cilësitë e një përshpirtjeje: Disku i stolisur me grurë të pahitur me sheqer të imët e mbi të emri i tij shkruar me kanellë e bajame ALEKS ZORBA. I kam ngulur sytë atij emri shkruar me germa kapitale dhe deti ngjyrë lilaku i Kretës shkrofëtin e më pushton të tërin. Fjalë, të qeshura, valle, dehje, ankthe, biseda të shtruara, thënë në zëmërherë, sy të rrumbullakët që me butësi e përçmim më janë qepur e s'më ndahen sikur më urojnë mirëseardhjen e sikur më thonë faleminderit, nga çasti në çast, përjetë.

Dhe, ashtu, sikundër shohim diskun e zbukuruar të vakisë ku varen nëpër të palë-palë gjithfarë kujtimesh të tjera si lakuriqë nate e të mbetur përjetë në zemër, po ashtu, pa e dashur, u thur që në çastet e para me hijen e Zorbës dhe një hije tjetër e dashur dhe, ca më pas, edhe një tjetër, hija e një gruaje të lënguar, të stërlyer, të stërputhur që e takuam me Zorbën në një bregdet ranor të Kretës, në detin e Libisë...

Me siguri, zemra, zemra e njeriut është një përrua i mbyllur gjaku dhe, në ndodhtë të hapet, do të rendin të pinë e të përtërihen të gjitha hijet e atyre që s'kanë të ngushëlluar e që gjithë po dendësohen rreth nesh dhe terratisin ajrin. Rendin të thëthijnë gjakun e zemrave tona, sepse e dinë mirë se tjetër ringjallje s'ka. Por, para të gjithëve, sot prin Zorba, me hapin e tij të madh, duke bërë mënjane hijet e tjera, sepse e di që kjo përshpirtje i takon atij.

Ejani, pra, t'i japim pak gjak nga gjaku ynë që të ringjallet, të bëjmë ç'është e mundur që të jetojë dhe një çikë ai, hamësi, pijaniku, punëmadhi, gruari edhe horri i horrave, Zorba. Shpirti më i gjerë, trupi më i plotë, zëri më i lirë që kam njohur në jetën time.



Nikos Kazantzakis
1883-1957

Zorba në shqip:

Jeta e Zorbës, shqipëruar nga Nazmi Rrahmani, Prishtinë, Rilindja 1978.

Jeta e Zorbës, shqipëruar nga Stavri Dajo, Tiranë, Albin 1996.

Zorba, shqipëruar nga Stavri Dajo, Tiranë, Albin 2001.

Zorba, shqipërim i ripunuar nga Stavri Dajo, Selanik, Literatus 2016.

Romani *Zorba* përbën një nga veprat më të njohura të shkrimtarit dhe kualifikohet ndër 100 librat më të mirë të të gjitha kohërave të letërsisë botërore, sipas Qendrës Norvegjeze të Librit (2002). *Zorba* është tërësimi i figurës së grekut tipik bashkëkohor, real, jetësor, simbol i njeriut të vetvetishëm që mishëron mendësinë popullore greke.

Zorba, si njeri praktik, i pandikuar nga librat, leximet dhe skemat filozofike, përpiqet që t'i dëshmojë shkrimtarit, përmes një dialogu bashkëkohor platonik, se përgjigjet që mendojnë çdo intelektual nuk gjenden tek ndërlkrimet logjike dhe deduksionet e pashpjegueshme, por në praktikën e përditshme të jetës; mjafton që ai të jetojë çdo çast me pasion si të jetë dita e fundit e jetës së tij dhe të punojë po me pasion, sikur nuk do të vdesë kurrë.

Çmimi: 1100 lek

